

Marrëveshje Bashkëpunimi Midis World Vision Albania dhe Dhoma e Biznesit të Diasporës, Shqipëri

Kjo Marrëveshje është hartuar nga dhe ndërmjet palëve të mëposhtme:

World Vision Albania (më poshtë, e quajtur WVA), një organizatë ndërkombëtare joqeveritare, me regjistrim gjykatë 2544 më 09/09/1999, NIPT J92127018B, me zyrën e saj shqiptare të vendosur në Rr. “Skënderbej”, Ndertesa “Gurten”, Kati 2, Tiranë, dhe adresë postare: Kutia Postare 1725, Tiranë, Shqipëri, e përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv dhe Përfaqësuesi Ligjor i saj, Znj. Eljona Elmazi, shtetase shqiptare, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, në cilësinë e Drejtorit Ekzekutiv (këtu e në vijim si “**WVA**”).

dhe

Dhoma e Biznesit të Diasporës, një organizatë e pavarur dhe jo-fitimprurëse, që ka si mision mbështetjen e investitorëve të Diasporës, me numër identifikues NUIS L923154520, me seli në adresën: Rr. Ibrahim Rugova, Sky Tower, kati i 13, Nr.3, Tiranë përfaqësuar nga Ardian Lekaj shtetase shqiptare, lindur në Tiranë, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, (në vijim referuar si “**Shoqëria**”).

(Të cilat veç e veç do të quhen “Pala” ndërsa së bashku “Palët”)

Neni I

Objekti i Marrëveshjes:

Ky bashkëpunim bazohet në:

1.1 Misionin e World Vision Albania që çdo fëmijë ka të drejtë të rritet me dinjitet dhe prosperitet, në mënyrë që të zhvillojë potencialin e tij të plotë. World Vision Albania punon në emër të fëmijëve, familjeve dhe komuniteteve më të cënueshme në Shqipëri, duke iu përgjigjur nevojave të tyre.

1.2 Misionin e Dhomës së Diasporës që të jetë një organizatë udhëheqëse e avokatisë së biznesit që punon në bazat rregullatore, ekonomike, legjislative dhe qytetare në nivel shtetëror dhe ndërkombëtar për të qenë një forcë për qëndrueshmëri afatgjatë të angazhimit të Diasporës si dhe në përkushtimin e Dhomës së Biznesit të Diasporës për të promovuar vlera të larta sociale e përkujdesje për komunitetet në të cilat operon.

1.3. Të dyja palët janë të angazhuara në bazë të vullnetit, të mirëbesimit dhe mirëkuptimit të ndërsjelltë në çdo rast të mundshëm, si dhe për të identifikuar, dokumentuar dhe zbatuar praktika të mira të bashkëpunimit për të siguruar suksesin e projekteve të partneritetit.

Palët janë partnerë në këto fusha bashkëpunimi:

1. Emergjena COVID -19
2. Mirërritja e fëmijëve dhe çdo nevojë/aktivitet që ka lidhje me këtë objektiv
3. Forcimi i rolit të familjes/përmirësimi i ekonomisë familjare
4. Aktivitete të tjera sipas dakortësisë së të dyja palëve

Neni 2

Partneriteti

Palët bien dakort se partnerizimi është një qasje e rëndësishme për të përmbushur objektivat strategjike të të dy organizatave në lidhje me mirëqenien e fëmijëve dhe familjeve të tyre. Këto partneritete mund të organizohen në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal.

Bazuar në këtë qasje, në çdo aktivitet të përbashkët:

- Palët do të respektojnë parimet e World Vision Albania për mbrojtjen e fëmijëve.
- Palët do të respektojnë ligjet në fuqi dhe/ose politikat për ruajtjen e të dhënave (kur është e aplikueshme).
- Palët do të ndjekin masat anti COVID-19 të vlefshme në momentin e aktivitetit.
- Palët do të kenë marrëveshje të veçanta për çdo aktivitet ku ruhet fryma e shprehur në këtë marrëveshje bashkëpunimi.

Neni 3

Detyrimet e palëve

Dhoma e Biznesit të Diasporës:

Ofron për WVA:

1. Mundësi për të bashkëpunuar me të gjithë anëtarët e saj kudo operojnë për të kontribuar në arritjen e objektivave të partneritetit.
2. Vë në dispozicion stafin (kur është e nevojshme) për të konceptuar/planifikuar aktivitetet e përbashkëta.
3. Rrjetin e saj të ndjekësve për të promovuar aktivitetet e përbashkëta.

World Vision Albania:

Ofron për Dhomën e Biznesit të Diasporës:

1. Burimet e saj njerëzore në Zyrën Kombëtare si dhe Zyrat në Zonat e Programit.
2. Mundësi të zbatimit të projekteve në zonat e specifikuar; (edhe të tjera sipas kërkesave të bashkëpunimit): Shkodër, Vau i Dejës, Mirditë, Lezhë, Pukë, Kurbin, Mat, Dibër, Bulqizë, Tiranë/Kamëz, Patos Librazhd, Mallakastër, Vlorë, Berat, Korçë (Maliq), Skrapar, Elbasan, Gjirokastër, Memaliaj, Durrës).
3. Mbledhje të dhënash/studime të përbashkëta/feed-back në lidhje me partneritete specifike për të cilat palët kanë rënë dakort.
4. Rrjetin e saj të ndjekësve për të promovuar aktivitetet e përbashkëta.

Neni 4

Kohëzgjatja e Marrëveshjes dhe përfundimi

4.1. Kjo marrëveshje hyn në fuqi pas nënshkrimit nga të dyja palët dhe nuk ka afat të përcaktuar përfundimi.

Neni 5

Përfundimi

5.1. Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi do të ndërpritet në bazë të ligjit, pa pasur nevojë për ndërhyrjen e një gjykate arbitrazhi, ku njëra palë nuk përmbush një nga detyrimet e saj sipas kësaj marrëveshje sipas Nenit 3 "Detyrimet e Palëve".

5.2. Secila nga palët mund ta ndërpresë këtë marrëveshje me njoftim paraprak të paktën 30 ditë para, pa kërkuar apo dhënë ndonjë zhdëmtim.

Neni 6

Komunikimi ndërmjet palëve

6.1. Çdo njoftim drejtuar nga njëra palë në tjetrën është i vlefshëm në qoftë se do të dërgohet me shkrim në adresën / selinë e përcaktuar në nenin I të kësaj kontrate ose me postë elektronike në adresat respektive të palëve:

World Vision Albania: Elenita Roshi, Marketing and Fundraising Manager. Email: Elenita_Roshi@wvi.org

Dhoma e Biznesit të Diasporës: Linda Dervishaj info@adbc.al

Neni 7

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

7.1. Çështjet që lidhen me vlefshmërinë e kësaj marrëveshje ose që rrjedhin nga interpretimi, ekzekutimi ose ndërprerja e saj, do të zgjidhen me mirëkuptim midis palëve, përndryshe palët mund t'i drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 8

Klauzola Korrupsioni

8.1. Palët deklarojnë se janë të vetëdijshëm të respektojnë rregullat për sjelljen e etikës së biznesit dhe ligjeve antikorrupsion, duke marrë parasysh se përmbushja e tyre është një element jetik i marrëdhënieve të tyre të bashkëpunimit.

Neni 9

Klauzola Përfundimtare

9.1 Kjo marrëveshje përfaqëson vullnetin e palëve dhe u përpilua në dy kopje, një kopje për secilën palë.

Dhoma e Biznesit të Diasporës
Kryetar i Dhomës së Biznesit të Diasporës

World Vision Albania
Drejtore Ekzekutive